



Komiteti i Patronëve dhe Këshilli i Administrimit të Fondacionit
zhvilluan një takim të përbashkët

ATË BENNY NË TIRANË ME KOMITETIN E PATRONËVE

Fondacioni ZKM, i themeluar në vitin 1993, e ka origjinën e tij në karizmën Montiane (e Atë Luigji Montit) e cila është gati dy shekullore. Atë Monti themeloi një komunitet njerëzish të shuguruar, Këshilli i Përgjithshëm i të cilit përbën Komitetin e Patronëve të Fondacionit. Në mes të muajit Maj i gjithë Komiteti mbërriti në Tiranë për të parë dhe eksploruar realitetin e Fondacionit, i cili po përjeton një zhvillim domethënës dhe duhet mbështetur në këtë rrugëtim. U sugjerua të krijohet në Shqipëri një "Grup" miqsh i Atë Montit për të mbështetur Fondacionin lidhur me veprimtarinë e tij të rëndësishme të formimit universitar dhe të kujdesit shëndetësor.



Atë Benny dhe këshilltarët gjatë një takimi
me Arqipeshkvin Tiranë-Durrës, Mons. Arian Dodaj.

Komiteti përbëhet nga p. Benny Mekkatt, indian, p. Giuseppe Pusceddu, italian, fr. Leonardo Lobato, argjentinas, p. Toussaint Tshingombe, RD e Kongos dhe fr. Ruggero Valentini, president i Fondacionit tonë.

Karizmat e vjetra dhe të reja në shërbim të të gjithëve, Nga UNË te NE: sfida për të ecur së bashku

NGA UNË TE NE: SFIDA PËR TË ECUR SË BASHKU



Për herë të parë, shprehje të ndryshme karizmatike që operojnë në Fondacion u takuan së bashku me qëllimin e një bashkëpunimi më të orientuar dhe të koordinuar. Bëhet fjalë për realitete të shumta katolike, disa shumë të njohura si Motrat e Bamirësisë të pranishme në selinë e Elbasanit, si dhe të tjera të mbetura brenda anëtarëve të tyre, si studentët Skautë italianë. Përveç këtyre dy realiteteve, janë gjithashtu të pranishëm edhe Fokolarët, Neokatechumenalët, lëvizja Bashkim e Çlirim, Komuniteti i Shën Egidios, Vincentianët, Adhuresit e Gjakut të Krishtit dhe së fundmi religjiozët e Atë Montit. Takimi ishte vëllazëror dhe do të propozojë në vazhdim një nismë të koordinuar nga dr. Salvatore Martinez, i lëvizjes së Ripërtërimit në Shpirtin e Shenjtë, si dhe anëtar i Këshillit të Administrimit të Fondacionit.

PASOJAT E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË DETE DHE NË SHËNDETIN E NJERIUT

U organizua për herë të parë në Shqipëri konferenca shkencore me temë “Pasojat e Ndryshimeve Klimatike në Detë dhe në Shëndetin e Njeriut”, e cila mblodhi kontributet më të mira shkencore dhe jo vetëm në këtë fushë. Ndryshimet klimatike kanë dhënë shenja të qarta të ndikimit në jetën dhe shëndetin e njerëzve në mbarë botën. Kështu që, kjo konferencë shërbeu si një reflektim për të ndërgjegjësuar veçanërisht të rinjtë për rolin që duhet të luajnë në mbrojtjen e natyrës dhe diversitetit të saj, duke reduktuar rrezikun e avancimit të ndryshimeve klimatike në të ardhmen.




Konferenca solli një reflektim të plotë dhe shumëdimensional mbi situatën e pasojave të ndryshimeve klimatike në mjedisin detar dhe ndikimin e tyre në shëndetin e njeriut, shoqëruar me informacione dhe ilustrime të dobishme dhe mjaft interesante. Konferenca përfaqësoi gjithashtu një aktivitet të rëndësishëm për kërkimin shkencor në Shqipëri, një vend që aspiron të anëtarësohet në Bashkimin Evropian dhe ka për detyrë të sigurojë mekanizma që mbrojnë natyrën, mjedisin dhe edukojnë opinionin publik mbi rëndësinë e të ushqyerit dhe të një mjedisi të shëndetshëm për të gjithë.



Java e kulturës italiane

TALKS@UNIZKM_2024 ARKITEKTURA BASHKËKOHORE ITALIANE

U zhvillua në Blue Box te Piramida e Tiranës, takimi i katërt i ciklit të konferencave “TALKS@UNIZKM_2024” ARKITEKTURA BASHKËKOHORE ITALIANE: Renato Capozzi dhe Federica Visconti – “Projekte për qytetin”. Ky aktivitet, i cili është një nismë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” u zhvillua në bashkëpunim me Ambasadën Italiane në Tiranë dhe Institutin Italian të Kulturës në kuadër të Javës Italiane. Gjatë konferencës u diskutua për projekte për qytetin, të krijuara me rastin e konkurseve, konsultimeve dhe kërkimeve akademike. U diskutua sesi këto projekte reflektojnë një qasje që ndërthur vazhdimësinë dhe/ose mosvazhdimësinë e qyteteve historike italiane, por edhe një dimension më të gjerë.





ALMA RËNJA (LULO)

Diplomuar për Inxhinieri.

Ka shërbyer në Fondacionin ZKM që nga fillimi i veprimtarisë së kësaj organizate në Shqipëri, duke pasur gjithmonë parasysh interesat dhe objektivat njerëzore dhe të krishtera të Fondacionit, të cilat i ka përvetësuar thellësisht. Në vitin 2004 dha kontributin e saj në grupin e punës për hapjen e Universitetit të ri "Zoja e Këshillit të Mirë". Që prej vitit 2007 dhe në vazhdim ofron shërbimin e saj pranë Zyrës së Rektorit të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" duke bashkëpunuar dhe ndihmuar gjatë gjithë kësaj periudhe të gjithë rektorët në detyrë ndër vite, me efikasitet, maturi dhe me frymën e përkatësisë institucionale, të njohur nga të gjithë.

Konferenca e gjashtë ndërkombëtare

STRATEGJIA PËR ZGJERIMIN E KËRKIMIT INFERMIERISTIK

U mbajt në sallën 'Aula Magna' të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" konferenca e gjashtë ndërkombëtare me temë "STRATEGJITË E REJA PËR ZGJERIMIN E BASHKËPUNIMIT NDERKOMBËTAR MBI KËRKIMIN INFERMIERISTIK DHE TË PROFESIONEVE SHËNDETËSORE". Konferenca u hap nga Rektori i Universitetit, Prof. Leonardo Palombi, i cili vlerësoi ndihmën që ofrojnë këto takime mbi edukimin dhe përgatitjen e gjeneratave të reja në fushën e shërbimeve jetike, si ajo infermieristike. Gjatë konferencës u prezantuan objektiva dhe rezultate kërkimore dhe studimore të avancuara



lidhur me shërbimet shëndetësore. Salla, e mbushur plot me studentë nga programet tona të studimit të Infermieristikës, Fizioterapisë dhe Mjekësisë, u kthye gjithashtu një vend ku u trajtuan tema të ndryshme që lidhen me sfidat e Infermierëve, të cilët janë një nga hallkat e kujdesit shëndetësor ndaj njerëzve dhe veçanërisht ndaj atyre që janë më në nevojë. Në konferencë morën pjesë profesorë me famë ndërkombëtare, profesorë të UKZKM-së, nën moderimin e Gennaro Rocco, drejtor i Qendrës ndërkombëtare kërkimore për shkencat Infermieristike.

TRE DEKADA TË INFERMIERISTIKËS



Kemi qenë, jemi dhe do të jemi djepi i standardeve më të mira akademike të infermieristikës. Tre dekada, tre breza, të bashkuar nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe nga pasioni për t'i dhënë më të mirën njerëzve që kanë nevojë për ndihmën tonë. Ndër to është edhe koordinatoreja jonë e programit të studimit të Infermieristikës, Enkeleda Gjini, PhD, e cila ka marrë modelin nga më të vjetrit dhe e transmeton te më të rinjtë. UKZKM është krenar për këtë sukses, nisur 30 vjet më parë në selinë e Elbasanit.

DY FONDACIONE, NJË KARIZËM

Karizmat janë dhurata të çmuara të Frymës së Zotit për Krijëzimin. Gjatë shekujve ato kanë karakterizuar jetën e kishave të krishtera. Nuk mungojnë karizmat në besimet e tjera, fara të Ungjillit që Zoti i shpërndan për jetën e botës. Fondacioni “Zoja e Këshillit të Mirë” i Tiranës dhe Fondacioni “Luigi Maria Monti” i Romës i referohen karizmës së Atë Montit, infermierit dhe edukatorit, besimtarit të nënës së Krishtit.



Më datë 13 maj, dy Fondacionet nënshkruan një marrëveshje për të zhvilluar iniciativë të kualifikuara në Shqipëri në dobi të të sëmurëve, veçanërisht në dermatologji, që ka qenë sektori kryesor i IDI-së së Romës, një spital i specializuar i nivelit ndërkombëtar, për më shumë se njëqind vjet.



KËRKUESJA JONË E RE SHKENCORE

Më datë 16 maj 2024, Bardha Karra morri titullin e doktoratës në “Tregjet, Bizneset dhe Konsumatorët”, në Departamentin e Ekonomisë së Ndërmarrjes, Universiteti i Romës, me temën “Ekonomia Qarkulluese për një turizëm të qëndrueshëm në rajonin e Ballkanit: rasti i Shqipërisë”.

Programi Erasmus +

JAVËT NDËRKOMBËTARE



Nga data 15 deri më 19 prill 2024, në kuadër të projektit Erasmus+, u organizua në Lille të Francës Java Ndërkombëtare, në të cilën morën pjesë universitete nga e gjithë bota. Këtë javë u organizuan takime akademike dhe kulturore. Universiteti ynë u përfaqësua nga Bardha.

Nga data 20 deri më 24 maj, në kuadër të Programit të Mobilitetit Ndërkombëtar të Personelit Akademik, Erasmus + për vitin akademik 2023-2024, profesoresha Eftiola Pojani u prit në Departamentin e Mjekësisë Klinike, Shëndetit Publik, Shkencave të Jetës dhe Mjedisore të Universitetit të Aquila-s.



ROLI I SHKENCAVE MJEKOLIGJORE NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJEVE PENALE

U zhvillua në Universitetin Katolik seminari ndërdisiplinor me temë “Roli i shkencave mjekoligjore në zgjidhjen e çështjeve penale”. “Seminaret ndërdisiplinore të të mërkurave” janë një nismë e Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë. Relatorë: Prof. Emiliano Giardina, Universiteti i Romës “Tor Vergata”, Prof. Giovanni Arcudi dhe Z. Giulio Puleri



të dy nga Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Moderator: Prof. Bruno Zappacosta, Dekan i Fakultetit të Mjekësisë.

Promovimi i ekologjisë integrale në 360°

...NJË NISIMË E RE

CREI
GRUPPO UNIVERSITARIO
UNIZKM TIRANA
CULTURA
e
RISORSE
per l'
ECOLOGIA
INTEGRALE



Grupi i Universitetit CREI është një krijim i ri i botës sonë universitare ZKM. Bëhet fjalë për një nismë që menaxhohet nga studentët, që synon promovimin e kulturës mjedisore dhe sociale sipas përkufizimit të famshëm të **Papa Françeskut**: Ekologji integrale. Ky grup u drejtohet të gjithë studentëve të Universitetit për të inkurajuar pjesëmarrjen në këtë projekt. Kontakti crei@unizkm.al

Atë Anish, nga India



DESTINACIONI TIRANË

Komuniteti Atë Monti i Tiranës priti mes anëtarëve të tij Atë Anish, 43 vjeç, nga Bolzano (Itali). I lindur në shtetin indian Kerala, ai është një anëtar i shuguruar i Komunitetit të themeluar nga i Lumi Luigji Monti. Ai u bë prift në vitin 2014 dhe jetoi në Kanada për disa vite. Në Fondacion do të kryejë shërbimin e tij në favor të të sëmurëve dhe të rinjve. Mirë se erdhe! (Benvenuto!)

TAKIMET E ARDHSHME dhe KURSE GJUHE

Centro Spiritualità Giovani

CUGLIERI 18-23 AGOSTO 2024

Esperienza per giovani dai 17 ai 25 anni



Signore
che io riabbia
la vista

Për më shumë informacion:
Centro Spiritualità Giovani
Località "Funtana 'e S'ozzu"
09073 Cuglieri – OR

+39/0785.950.007 – 06/583.307.50
info@csg-cuglieri.org



SUMMER
SCHOOL
9th edition

Roots of War
& Establishment
of a Lasting
Peace

RAUL CARUSO

Catholic University of the Sacred Heart, (Italy)
and Catholic University Our Lady of Good Counsel
- CESPIC Director

CHRISTOS KOLLIAS

University of Thessaly (Greece)

HAN DORUSSEN

University of Essex (UK)

SUBHASISH CHOWDHURY

University of Sheffield, (UK)

VINCENZO BOVE

University of Warwick (UK)

LISA HULTMAN

University of Uppsala (Sweden)

TOBIAS BÖHMELT

University of Essex (UK)

ADELAIDE BARONCHELLI

University of Torino (Italy)

ELENA PAGLIALUNGA

Università Roma 3 (Italy)

SARAH LANGLOTZ

University of Goettingen (Germany)

JESSICA DI SALVATORE

University of Warwick (UK)

Roots of War
& Establishment
of a Lasting
Peace

September
3-10th
2024



SUMMER
SCHOOL
9th edition

<https://unizkm.al/categories/cespic/posts>



Mëso
ITALISHT
me ne

PROVIM NDERKOMBËTAR PLIDA

KURSE A1-C2

- ✓ Gjuhë specialiteti
- ✓ Italishte e folur / e shkruar
- ✓ Kurs përgatitor për certifikatë
- ✓ Në grup / individual
- ✓ Në klasë / në distancë

n.hoti@unizkm.al / segreteria.cla@unizkm.al
+355 44 54 14 20 / +355 69 705 9292



Mëso
GJERMANISHT
me ne

PROVIM NDERKOMBËTAR TELC

KURSE A1-C2

- ✓ Gjuhë specialiteti
- ✓ Gjermanishte e folur / e shkruar
- ✓ Kurs përgatitor për certifikatë
- ✓ Në grup / individual
- ✓ Në klasë / në distancë

n.hoti@unizkm.al / segreteria.cla@unizkm.al
+355 44 54 14 20 / +355 69 705 9292



Mëso
ANGLISHT
me ne

KURSE A1-C2

- ✓ Gjuhë specialiteti
- ✓ Anglishte e folur / e shkruar
- ✓ Kurs përgatitor për certifikatë
- ✓ Në grup / individual
- ✓ Në klasë / në distancë

n.hoti@unizkm.al / segreteria.cla@unizkm.al
+355 44 54 14 20 / +355 69 705 9292